




Informacione dhe oferta për jetën në Ostermundigen



www.ostermundigen.ch

Mirë se vini në Ostermundigen

Të nderuara lexuese, të nderuar lexues

Kam kënaqësinë që në emër të Këshillit të Komunës së Ostermundigen -it t`u uroj mirë se ardhje. Unë shpresoj që ju do të përshtateni mirë dhe shpejtë në Ostermundigen dhe se do t`ju pëlqej këtu.

Në këtë broshurë të shkurtër kemi përmbledhur posaçërisht për ju informacionet më të rëndësishme, që kanë të bëjnë lidhur me jetën në Zvicër dhe veçanërisht në Ostermundigen. Ne dëshirojmë t`iu informojmë sa më mirë, që të përfitoni mjaftueshëm nga ofertat tona.

Në çdo shënim do të gjeni një përshkrim të shkurtër se çfarë përmban oferta. Përveç kësaj do të gjeni të dhënat për kontaktim ku shkruhet më saktësisht se ku mund të informoheni dhe të lajmëroheni.

Nëse keni pyetje mund të lajmëroheni çdo kohë në sportelin e Administratës së Komunës Gemeindeverwaltung, Schiessplatzweg, të shkruani një e-mail apo të telefononi.

Ju dëshiroj një lexim informativ dhe shumë kontakte frytdhënëse me institucione të ndryshme!

Christian Zahler
Kryetari i Komunës

Chr. Zahler

...nëse dëshironi të mësoni ma shumë lidhur me Ostermundigen-in: www.ostermundigen.ch

Gemeindeverwaltung, Schiessplatzweg 1:

Të hënë: 08.00 h deri 11.45 h dhe 13.45 h deri 18.00 h.

Të martën deri të enjtën: 08.00 h deri 11.45 h dhe 13.45 h deri 17.00 h.

Të premten: 08.00 h deri 11.45 h dhe 13.45 h deri 16.00 h.

Gjatë ditëve të tjera dhe në ditët e festave Administrata e Komunës është e mbyllur.

Telefoni: 031 930 14 14

E-Mail: info@ostermundigen.ch

Përmbajtja

1.	Fëmijët dhe të rinjtë.....	4
1.1	Kopshtet dhe shkollat.....	4
1.2	Shkolla Ditore.....	4
1.3	Çerdhja.....	4
1.4	Kujdestarja për fëmijët (përkujdesje ditore).....	5
1.5	Tryezë ushqimi për drekë.....	5
1.6	Grupet e lojës për fëmijë (Spielgruppen).....	5
1.7	Grupet e lojës në pyll.....	6
1.8	Kursi i gjermanishtes për fëmijët parashkollor.....	6
1.9	Purzelbaum - Rrotullime me kokë, lojëra për fëmijët, që zhvillohen jashtë dhe me shumë fantazi.....	6
1.10	Takimi për të rinjtë dhe për kohën e lirë "Hangar".....	7
1.11	Vallëzim për vajza - Streetdance for Girls.....	7
1.12	Vendi i javës së tregut – për të fituar para xhepi.....	7
2.	Koha e lirë dhe arsimit.....	8
2.1	Shoqatat.....	8
2.2	Biblioteka.....	8
2.3	Ludoteka.....	8
2.4	Shërbimi për shkresa.....	8
2.5	Kurse gjuhësore dhe komunikimi në Ostermundigen.....	9
2.5.1	Kurse të gjermanishtes.....	9
2.5.2	Takimi i gjermanishtes me një grup themelor ekumenik.....	9
2.6	Pishina në hapësirën e lirë.....	10
3.	Banimi.....	10
4.	Heqja e mbeturinave në Ostermundigen.....	10
5.	Shëndeti.....	11
5.1	Sigurimi shëndetësor.....	11
5.2	Përkujdesje jashtë spitali "Spitex" për sëmundjen dhe shëndetin.....	12
6.	Puna.....	12
6.1	Zyra për të papunët.....	12
6.2	TRiiO, këshillim, ndihmë në kërkimin e punës dhe te procesi i punës.....	12
6.3	Kurse dhe këshillime për përmirësimin e shanseve në profesion.....	13
6.4	Formazione.....	13
6.5	BIZ, Qendra për Këshillim dhe Informim lidhur me Profesionin.....	13
7.	Ndihma sociale.....	13
8.	Të ndryshme.....	14
8.1	Byroja e gjërave të humbura.....	14
8.2	Numrat e urgjencës.....	14
8.3	Kontakti me udhëheqësit e institucioneve.....	14

1. Fëmijët dhe të rinjtë

1.1 Kopshtet dhe shkollat

Kopshti është falas, por nuk është i obligueshëm. Megjithatë ai rekomandohet shumë. Për këtë arsye praktikisht të gjithë fëmijët e vizitojnë kopshtin. Nëse fëmija është mjaft i rritur që të pranohet në kopshtin e fëmijëve, prindërve u dërgohet një letër për ta regjistruar atë në kopsht.

Shkolla nga klasa e parë deri në të nëntën është gjithashtu falas, por e obligueshme. Prindërit janë të detyruar t'i dërgojnë fëmijët e tyre rregullisht në shkollë. Ata duhet të marrin pjesë në mbrëmjet dhe në bisedat prindërore. Nëse keni ndonjë pyetje lidhur me fëmijën tuaj dhe shkollën, merrni kontakt me mësuesin apo mësuesen.

Datat e pushimeve shkollore: shiko në www.ostermundigen.ch (dhe nga këtu më tutje në nënfaqet e web-it: Leben und Arbeiten, Schule, Ferienkalender).

Drejtoria Edukativo-Arsimore (Erziehungsdirektion) organizon së paku njëherë në vit një takim informativ për prindërit e huaj. Këtu mësoni çdo gjë për sistemin tonë shkollor. Datën se kur mbahet ky takim e gjeni në faqen e internetit www.erz.be.ch nën titullin „Fachportal Bildung“, Interkulturelle Bildung / Kurse / Veranstaltungen.

Informacione të tjera si dhe fletë e broshura informative në gjuhë të ndryshme mund të gjeni te Drejtoria Edukativo-Arsimore e Kantonit të Bernës (Erziehungsdirektion des Kantons Bern), Sulgeneckstrasse 70, 3005 Bern; telefoni: 031 633 85 11, www.erz.be.ch (në nënfaqet (link-un "Fachportal Bildung" / interkulturelle Bildung / Dokumente).

1.2 Shkolla Ditore

Shkolla Ditore është një shkollë, në të cilën fëmijët do të jenë nën përkujdesje që nga mëngjesi në orën 07.15 h e deri në mbrëmje në orën 17.30 h. Këtu fëmijët do të kenë edhe ndihmë në detyrat e shtëpisë, përkujdesje gjatë kohës së lirë dhe gjithsesi edhe ushqimin për drekë.

Informacionet dhe regjistrimi:

Gemeinde Ostermundigen, Abteilung Bildung, Kultur und Sport; Mitteldorfstrasse 6; 3072 Ostermundigen; telefoni: 031 930 14 14.

Shpenzimet për Shkollën Ditore njehsohen sipas të ardhurave të prindërve.

1.3 Çerdhja

Çerdhja është e caktuar për fëmijët para moshës shkollore (prej moshës 15 javësh deri sa të hyjnë në shkollë). Prindërit të cilët punojnë mund t'i lënë fëmijët gjatë ditës këtu për përkujdesje.

Orari i punës: të hënën deri të premten, prej orës 06.15 h deri në orën 18.15 h.

Vendi: Bernstrasse 66, 3072 Ostermundigen

Telefoni: 031 931 63 03 e-maili: kindertagesstaette@ostermundigen.ch

Shpenzimet për çerdhe njësohen sipas të ardhurave të prindërve.

1.4 Kujdestarja për fëmijët (përkujdesje ditore)

Kjo ofertë është gjithashtu për prindërit të cilët gjatë ditës nuk mund të përkujdesen për fëmijët e tyre. Përkujdesja ndaj fëmijës do të bëhet në shtëpinë e kujdestares dhe në shumicën e rasteve në shoqëri me fëmijët e tjerë. Institucioni për Çështjen e të Rinjve (Jugendamt) verifikon punën e kujdestares për fëmijë.

Për fushat e përshtatshme për lojë gjatë ditës ju informon ndërmjetësuesja për këto vende Gabriele Krebs, Mitteldorfstrasse 6a, 3072 Ostermundigen; telefoni: 031 930 11 41.

Shpenzimet për përkujdesjen ditore të fëmijës njësohen sipas të ardhurave të prindërve.

1.5 Tryezë ushqimi për drekë

Fëmijët e kopshtit dhe të shkollës deri në klasën e 9-të do të mbikëqyren gjatë kohës së drekës dhe do t'u shtrohet një racion i nxehtë. Pas ngrënës fëmijët mund të luajnë, të sajojnë, vizatojnë, të dëgjojnë muzikë, të pushojnë apo t'i bëjnë detyrat.

Orari i punës: Tryeza e ushqimit për drekë është e hapur prej të hënës deri të premten, prej orës 11.00 h deri në orën 13.30 h.

Vendi: Obere Zollgasse 15, në përdhesen e kishës së reformuar.

Informacione dhe regjistrim: Jugendamt (Institucioni për Çështjen e të Rinjve), Mitteldorfstrasse 6a, 3072 Ostermundigen;
Telefoni: 031 930 12 77, e-maili: jugendamt@ostermundigen.ch

Shpenzimet e tryezës së ushqimit për drekë njësohen sipas direktivave të kantonit.

1.6 Grupet e lojës për fëmijë (Spielgruppen)

Janë të dedikuara për fëmijët prej moshës 3 vjeçe deri sa të fillojnë me kopshtin.

Në një grup prej 8 fëmijësh, fëmija i juaj do të përkrahët në lojë, në lëvizje dhe në të shprehurit. Grupet e lojës zhvillohen dy herë në javë në orën 09.00 h deri në orën 11.00 h dhe të hënën ora 14.30 deri në orën 16.30. Se në cilën ditë të javës do ta vizitoni fëmijët paradite grupin e lojës, sipas mundësive e zgjedhin prindërit.

Vendi: Reformierte Kirche, Obere Zollgasse 15, Katholische Kirche, Obere Zollgasse 35, 3072 në Ostermundigen.

Informacione dhe regjistrim: Giovanna Eggimann: 031 932 03 49

Shpenzimet: për anëtarët e shoqatës së prindërve 140.- franga, për të tjerët 165.- franga në çerek viti.

1.7 Grupet e lojës në pyll

U dedikohet fëmijëve prej 3 vjetësh. Këtu fëmijët mund ta përjetojnë natyrën me të gjitha shqisat. Të rrëfyerit dhe përjetimi kanë një vlerë të posaçme. Këto grupe loje në pyll zhvillohen të martën dhe të enjtën paradite nga tri orë.

Sajimi dhe loja në pyll për fëmijët prej moshës 5 deri në moshën 9 vjeçe zhvillohen çdo të premte pasdite në orën 14.00 h deri në orën 17.00 h.

Lajmërimi dhe informacionet: Christine Röthenmund 031 782 04 44 e-maili daschis@bluewin.ch. Shpenzimet: njehsohen sipas marrëveshjes.

1.8 Kursi i gjermanishtes për fëmijët parashkollor

Fëmijët prej moshës dy vjet e gjysmë që dinë pak gjermanisht apo nuk dinë fare, këtu e mësojnë gjermanishten duke luajtur. Ata çdo herë duhet të shoqërohen nga njëri prind.

Kursi zhvillohet gjithmonë të hënën prej orës 9.30 h deri në orën 10.30 h.

Vendi: Në lokalën e grupit të lojës (Spielgruppe) të kishës reformuese, Obere Zollgasse 15, 3072 Ostermundigen

Lajmërimi dhe informacione të mëtutjeshme: Janine Bieri, telefoni: 031 931 23 82.

Shpenzimet: sipas zgjatjes së çerek vitit (6-12 takime) diku mes 30.- frangave dhe 60 .- frangave.

1.9 Purzelbaum - Rrotullime me kokë, lojëra për fëmijët, që zhvillohen jashtë dhe me shumë fantazi

Këtu mund të lëvizin fëmijët të lirë gjatë lojës dhe kënaqësisë. Ka disa vegla për lojë: kolovajzë (luhatje), kodra, gurë, trungun e një lisi dhe një qerre me vegla loje.

Qëllimi është që fëmijët prej moshës 6 vjeçe ta kenë në dispozicion një hapësirë të lirë për lojë, që të kenë mundësi të zhvillohen dhe shpalosen sa më afër lojës natyrore. Këtu bënë pjesë fantazia dhe kreativiteti. Dy persona gjithmonë do të jenë prezent për përkujdesje. Lajmërimi nuk është i nevojshëm.

Fëmijët nën moshën 6 vjeçe guxojnë të vijnë vetëm nën shoqërimin e prindërve dhe motrave e vëllezërve më të moshuar.

Orari i punës: e mërkurë dhe e premte - 14.00 h deri 17.00 h, prej 1 prill deri 31 tetor (përfunduar gjatë pushimeve shkollore të verës).

Vendi: te Seepark (Zoss-Strasse/Mitteldorfstrasse) në Ostermundigen, autobusi 10, stacioni Zollgasse dhe pastaj pyetni se ku është "Purzelbaum" .

Udhëheqja dhe informimi: 031 931 02 51.

Oferta „Purzelbaum“ është një shërbim falas i komunës së Ostermundigen-it.

1.10 Takimi për të rinjtë dhe për kohën e lirë "Hangar"

Kjo qendër është e dedikuar për fëmijët dhe të rinjtë. Brenda mund të luhet biliard, tenis dhe futboll tavoline si dhe lojëra të tjera në shoqëri. Jashtë mund të luhet basketboll. Nëse djemtë dhe vajzat duan që të jenë vetëm në shoqërinë e tyre ekziston një hapësirë ndaras për vajzat e një për djemtë.

Këtu zhvillohen shpesh teatri shkollor, koncerte dhe festa. Për mbikëqyrje gjithnjë është prezent një person i rritur.

Orari i punës

Takimi i nxënësve: e mërkurë dhe e premte prej orës 14.00 h deri në 17.00 h.

Takimi i të rinjve për të rinjtë e lëshuar nga shkolla: e mërkurë prej orës 19.00 h deri në 22.00 h.

Vendi: Oberfeldweg 48, 3072 Ostermundigen; telefoni: 031 931 02 51 ose 031 931 02 52.

Takimi i nxënësve dhe të rinjve janë shërbime falas të komunës së Ostermundigenit.

Lokalet e takimit të të rinjve dhe kohës së lirë "Hangar" mund të merren edhe me qira. Pyetje mes telefonit të martën dhe të enjten prej orës 10.00 h deri 12.00 h dhe të mërkurën prej 13.00 h deri në 16.00 h nën telefonin: 079 224 13 92.)

1.11 Vallëzim për vajza - Streetdance for Girls

Kurs vallëzimi për vajzat deri në moshën 12 vjeçe, çdo të marte, në orën 18.30 h deri në orën 19.30 h dhe për femrat e reja nga mosha 12 vjeçe, në orën 19.15 deri në orën 21.00 h.

Vendi: Në lokalet e të rinjve dhe të kohës së lirë - Hangar.

Shpenzimet: 5.- franga për çdo trajnim.

Një trajnim provë është falas

1.12 Vendi i javës së tregut – për të fituar para xhepi

Të rinjtë me anë të vendit të javës së tregut me disa punë të vogla mund ta përmirësojnë gjendjen e parave të xhepit. Ky lloj tregu ndërmjetëson punë të vogla në afërsi të vendbanimit.

Mosha: për të rinjtë prej 13 vjetësh.

Të interesuarit lajmërohen te:

Jugendamt Ostermundigen, Urs Imhof, Mitteldorfstrasse 6a, 3072 Ostermundigen.

Telefoni: 031 930 12 74

byroja ndërmjetësuese direkt 079 489 35 74

E- maili: jugendamt@ostermundigen.ch

2. Koha e lirë dhe arsimit

2.1 Shoqatat

Në Ostermundigen ekzistojnë shumë shoqata sportive si dhe palestra "Time Out". Momentalisht në Ostermundigen ofrohen këto lloje sportesh: badminton, top grushti, futboll, hendboll, xhudo, karate, sport artistik me vegla, not, tenis, tenis tavoline, edukatë fizike, hokej dhe volejball.

Ostermundigen i ka shoqatat vijuese të muzikës: një shoqatë muzike për të rinjtë, tri shoqata të muzikës së instrumenteve frymorë, një orkestër, një grup daullesh, grupin Steel dhe shoqata të ndryshme këndimi.

Të gjitha këto grupe për kohën e lirë i gëzohen anëtarëve të rinj. Të gjitha informacionet se ku dhe kur zhvillohen këto aktivitete i gjeni në faqen e internetit www.ostermundigen.ch (në nën faqen "Vereine" - shoqatat) apo në Abteilung Bildung, Kultur und Sport (Repartin Arsimimi, Kultura dhe Sporti) në Mitteldorfstrasse 6, telefoni: 031 930 14 14.

2.2 Biblioteka

Këtu mund të huazohen libra (libra shkencore dhe letërsi artistike), lojëra për të dëgjuar dhe filma. Ekzistojnë edhe mjete të tjera gjuhësore dhe mësimi.

Orari i punës:

E martë, e enjte, e premte 15.00 h deri 18.30 h

E mërkurë: 14.00 h deri 18.30 h

E shtunë: 10.00 h deri 15.00 h

Të dielën dhe të hënën është e mbyllur

Vendi: Untere Zollgasse 1, 3072 Ostermundigen;

Telefoni: 031 931 93 27

2.3 Ludoteka

Këtu mund të huazohen lojëra dhe gjëra loje.

Orari i punës:

E hënë dhe e mërkurë: 14.30 h deri 18.00 h, të premten: 17.00 h deri 19.00 h

Vendi: Zoss-Strasse 2, 3072 Ostermundigen; telefoni: 031 931 13 13

2.4 Shërbimi për shkresa

Shërbimi për shkresa me vullnetarët e tij ju përkrah më kënaqësi: që të kuptoni, të lexoni dhe të shkruani në gjermanisht (p.sh.: në plotësimin e një formulari zyrtar, të shkruarit e një letre, të shkruarit e një aplikimi).

Orari i punës:

Shërbimi për shkresa është i hapur çdo të enjte rreth orës 17.00 h dhe 19.30 h.

Vendi: Mitteldorfstrasse 6a (Administrata e Komunës).

Shërbimi për shkresa është një shërbim falas që punëtorët e bëjnë vullnetarisht.

2.5 Kurse gjuhësore dhe komunikimi në Ostermundigen

2.5.1 Kurse të gjermanishtes

Kursi ofrohet në dy nivele të ndryshme.

Ky kurs zhvillohet ose të hënave prej orës 17.15 h deri në orën 18.45 h ose të shtunave prej 10.00 h deri në orën 11.30 h. Kursi mbahet nëse lajmërohen së paku 8 persona.

Vendi i kursit: Schulhaus Möсли, Kirchgrundstrasse 25, 3072 Ostermundigen.

Një njësi kursi zgjatë 90 minuta dhe kushton 12 .- franga.

Një kurs përbëhet nga 16 njësi. Lajmërimi është i obligueshëm.

Ju mund të lajmëroheni në këtë adresë:

Anmeldung Erwachsenenbildung

Frieda Notter

Mitteldorfstrasse 6

3072 Ostermundigen

E-Mail: frieda.notter@ostermundigen.ch

Telefoni: 031 930 12 82.

2.5.2 Takimi i gjermanishtes me një grup themelor ekumenik

Ekzistojnë grupe të ndryshme mësimi me nga një mësues/e. Pas mësimit do të ketë një shujtë. Këtu hyjnë në rend të parë bisedat dhe kontaktet.

Takimi i gjermanishtes zhvillohet çdo të marte prej orës 14.00 h deri në 16.30 h.

Vendi: Në lokalet e qendrës kishtarë "Guthirt".

Informacione: Anny Hug, telefoni: 031 932 15 00

Takimi i gjermanishtes është një ofertë falas e grupit themelor ekumenik.

2.6 Pishina në hapësirën e lirë

Ndodhet në Dennigkofenweg 120.

Orari i punës:

Prej muajit maj deri në shtator prej orës 9.00 h deri në orën 19.00 h

Qershor, korrik dhe gusht prej orës 9.00 h deri në orën 20.30 h.

Sezoni i pishinës në hapësirën e lirë zgjatë prej vikendit të dytë të muajit maj deri në të dielën e tretë të shtatorit.

3. Banimi

Lidhur me kërkimin e banesës: Njoftimet për banesa i gjeni në faqet e ndryshme të internetit dhe në gazeta.

Ju e bëni përmes telefonit një termin, që ta shikoni banesën. Pasi ta shikoni banesën e merrni një formular, të cilin e plotësoni nëse keni interesa për atë banesë dhe e dërgoni në adresën e shkruar.

Nëse ju ndahet banesa dhe jeni ende të pajtimit për ta pranuar, duhet ta nënshkruani kontratën e banesës.

Kësaj kontrate – kupto banesës – mund t'i jepet dorëheqje gjatë vitit vetëm në kohërat e përcaktuara me kontratë. Përveç kësaj duhet t'i dërgohet shkresa qiradhënësit tre muaj më herët. Rregullat janë të shkruara më saktësisht në kontratë.

Njëherazi në kontratë është e përcaktuar se sa do të paguhet depoja e qirasë. Nuk guxon të tejkalohej qiraja e tre muajve. Këto para do të paguhet në një llogari të veçantë që ua jep qiradhënësi. Kur të ndërpritet kjo kontratë depoja e qirasë ju kthehet përsëri prapa, nëse e keni paguar rregullisht banesën.

Informacione të më tutjeshme lidhur raportin e banimit mund të merrni te: Mietamt në Mitteldorfstrasse 6a, 3072 Ostermundigen; telefoni: 031 930 12 60

Veni re: Institucioni për Banim (Mietamt) nuk ndërmjetëson banesa, ky institucion është kompetent vetëm për pyetjet rreth kontratave të banimit.

4. Heqja e mbeturinave në Ostermundigen

Sa më shumë që është e mundur duhet t'i evitohet mbeturinat dhe aty ku është e mundur të ripërdoren (ripërpunohen) përsëri. Me këtë e ruajmë ambientin. Nga letrat dhe kartonët e vjetër, p.sh mund të bëhet përsëri letër e re dhe nga konservat dhe letrat e alumiuara mund të bëhen përsëri materiale të ngjashme. Ne i dëgjim vetëm mbeturinat që nuk mund të ripërdoren.

Në komunë ekzistojnë vende të ndryshme për hedhje të mbeturinave që mund të ripërdoren, (p.sh. për letër dhe karton, PET-shishet, bateritë, pajisjet, tekstillin, konservat dhe letrat e alumiuara).

Në thasët e taksuar të bërllokut futen vetëm mbeturinat që nuk mund të ripërdoren më. Pasi thasët e bërllokut kushtojnë do të kurseni para, nëse i dërgoni mbeturinat që ripërdoren në vendet e caktuara të grumbullimit ku në shumicën e rasteve mund të jepen falas, nëse evitoni mbeturinat dhe nëse i klasifikoni sipas llojit (p.sh. letrat).

Lidhur me temën "Heqja e mbeturinave" ekziston një fletushkë në gjuhë të ndryshme. Atë mund ta merrni në: Gemeindeverwaltung am Schiessplatzweg 1 dhe në Bernstrasse 65d ose mund ta shkarkoni përmes internet në www.ostermundigen.ch .

Veni re: Nëse nuk e bëni korrekt heqjen e mbeturinave mund të dënoheni me një gjobë.

5. Shëndeti

5.1 Sigurimi shëndetësor

Është e obligueshme që secili person të ketë një sigurim bazë shëndetësor. Ju mund të zgjidhni vetë se cili sigurim shëndetësor do t'i marr përsipër shpenzimet tuaja në rast sëmundjeje apo aksidenti.

Në faqen e internetit www.bundespublikationen.ch e gjeni "Gesundheitswegweiser Schweiz" (Udhërrëfyesin e shëndetit" në Zvicër). Ky ofron një vështrim të përgjithshëm lidhur me sistemin shëndetësor në Zvicër dhe përgjigjet në pyetje të ndryshme si : A kam të drejtë për një përkthyes/përkthyesë? Ç`janë "mjekët familjar" dhe a duhet familja t`ia qojë pacientit ushqimin në spital.

Ky udhërrëfyes i shëndetit ekziston në shumë gjuhë.

"Gesundheitswegweiser Schweiz" - Udhërrëfyesi i shëndetit – Zvicër mund ta merrni edhe në: BBL, Vertrieb Publikationen, 3003 Bern, apo mes telefonit: 031 325 50 50.

5.2 Përkujdesje jashtë spitali "Spitex" për sëmundjen dhe shëndetin

SPITEX ofron shërbim për njerëzit e çdo moshe, që kanë nevojë për përkrahje në përkujdesje apo në punët e shtëpisë. SPITEX sjell një spektër të gjerë të shërbimeve për ata që kanë nevojë për ndihmë. Krahas përkujdesjes mjekësore dhe përkrahjes në punët e shtëpisë ky shërbim sjell edhe racionet e ushqimit në shtëpi.

Orari i punës së byrosë:

E hënë deri të premten: 8.00 h deri 11.30 h dhe 14.00 h dhe 16.00 h

Jashtë orarit të punës telefoni kujdestar i regjistron thirrjet tuaja dhe ne do t'ju thërrasim prapa.

Vendi: SPITEX-Zentrum, untere Zollgasse 4, 3072 Ostermundigen;

Telefoni: 031 932 14 14

E-maili: Spitex@ostermundigen.ch

Shpenzimet: shërbimet e përkujdesjes paguhen nga sigurimi shëndetësor, shërbimet në amvisni njehsohen sipas tarifës së sociale, kurse shërbimi për racionet e ushqimit paguhet nga vetë klienti / klientja. .

6. Puna

Nëse jeni duke kërkuar një punë, varësisht nga situata e juaj eventualisht mund t'iu hyjnë në punë institucionet vijuese:

6.1 Zyra për të papunët

Personat që kanë të drejtën e parave të papunëve apo janë të interesuar për ndërmjetësimin e ndonjë pune do të lajmërohen nga kjo zyrë në Qendrën Ndërmjetësuese për Punë të Kantonit RAV.

Vendi i Zyrës për të Papunët: Anlaufstelle für Erwerbslose: Bernstrasse 63, 3072 Ostermundigen; telefoni: 031 930 12 45, e - maili: erwerbslose@ostermundigen.ch

Shërbimet e Zyrës për të Papunët bëhen falas.

6.2 TRiiO, këshillim, ndihmë në kërkimin e punës dhe te procesi i punës

Organizata e pavarur TRiiO ofron ndihmë dhe këshillim në të shkruarit e aplikimeve për punë. TRiiO i ndihmon posaçërisht personat që nuk këshillohen dhe përkrahen nga RAV.

Orari i punës::

E hënë	9.30 h deri 12.00 h	14 h deri 16.30 h.
E martë	9.30 h deri 12.00 h	pasdite mbyllur
E mërkurë deri të premten	9.30 h deri 12.00 h	14. 00 h deri 16.30

Ort: TRiiO, Spitalgasse 33, 3011 Bern;

E hënë deri të premten prej orës 09.30 h deri 12.00 h dhe prej 14.00 h deri 16.30 h.

Vendi: TRiiO, Spitalgasse 33, 3011 Bern;

Telefoni: 031 311 91 55, e-maili: info@triio.ch

Këshillimet bëhen falas.

6.3 Kurse dhe këshillime për përmirësimin e shanseve në profesion

CFD Mentoring projekti:

Synimi i këtij projekti është, që me anë të mentorimit të zgjerohet hyrja në informacionet dhe mekanizmat ndërlidhëse të tregut të punës, që të përkrahet integrimi i emigranteve/emigrantëve të kualifikuar në tregun e punës.

Telefoni: 031 300 50 60.

E-maili: theodora.leite@cf-d-ch.org ose info@cf-d-ch.org.

Faqja e internetit: www.cfd-ch.org / Migrationspolitik / Aktivitäten / Projekte

6.4 Formazione

Oferta arsimimi: kurse për mësimin e gjuhës dhe për informatikë si dhe kurse profesionale dhe për arsimim të përgjithshëm.

Vendi: Freiburgstrasse 139c, 3008 Bern;

Telefoni: 031 381 81 33, e-maili: info@formazioneberna.ch

6.5 BIZ, Qendra për Këshillim dhe Informim lidhur me Profesionin

Këtu të rinjtë dhe të rriturit mund të këshillohen lidhur me zgjedhjen e shkollimit apo profesionit. Pastaj ju jepen materiale të shumta lidhur me këto tema.

Vendi: Bremgartenstrasse 37, Postfach 3001 Bern.

Kontakti: Monika Lichtsteiner, telefoni: 031 633 81 80

Oferta e BIZ-it është një shërbim falas.

7. Ndhimja sociale

Shërbimi Social i përkrah personat që ndodhen në një gjendje të rëndë financiare. Nëse keni një problem social apo financiar ose thjeshtë nëse keni nevojë për një këshillim apo informacion lidhur me këto pyetje mund të lajmëroheni te Shërbimi Social.

Juve u përcaktohet një termin për një bisedë me një punëtor social gjegjësisht me një punëtoreshë sociale. Natyrisht që edhe ju duhet të vini në shërbim të gjitha aftësitë për të përmirësuar gjendjen tuaj.

Shuma e parave të ndihmës sociale njehsohet sipas direktivave të parapara.

Orari i punës: sipas orarit normal të punës në zyra.

Vendi: Sozialdienste, Bernstrasse 63, 3072 Ostermundigen;
Telefoni: 031 930 12 00, e-maili: sozialdienst@ostermundigen.ch

Ofertat e përmendura të ndihmës sociale janë shërbime falas të komunës së Ostermundigen -it.

8. Të ndryshme

8.1 Byroja e gjërave të humbura

Për gjërat e humbura lajmërohuni në sportelin e: Polizeiinspektorat am Schiessplatzweg 1.

8.2 Numrat e urgjencës

Zjarrfikësit	118	
Policia	117	
Urgjenca mjekësore, ambulanca	144	
Ndihmë e menjëhershme, këshillime telefonike për fëmijë	147	ose www.147.ch .

(Një telefonatë është anonime, falas dhe nuk regjistrohet në llogarinë telefonike).
Urgjenca për prindër: 044 261 88 66

8.3 Kontakti me udhëheqësit e institucioneve

Për folësit: shqip, serbo-kroatisht, tamilisht dhe turqisht, për secilin nga ky grup ekziston një person kontaktues.

Këta mund të kontaktohen nëse keni pyetje lidhur me komunën e Ostermundigenit, me secilin prej tyre mund të flisni në gjuhën përkatëse amtare.

Shqip: zotëri Remzi Reka, telefoni: 031 931 98 52 ose 079 347 68 32 e-maili: valbona.reka@nia.ch

Serbo-kroatisht: vakant

Tamilisht: zonja Malika Thevaraja, telefoni: 031 931 65 82 ose 077 258 20 52, e-maili: cutebumeka@hotmail.com

Turqisht: zonja Yelda Kutay, telefoni: 031 931 63 60 ose 076 394 91 92 e-maili: yele@hispeed.ch